



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1447/24 Datë: 23.07.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 125-të, mbajtur me datë 03.07.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *E-Qeverisja MA 120 ECTS R, me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
 - *Financa dhe Kontabilitet i Aplikuar BSc180 ECTS R me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
- II. Akreditohen programet e studimit të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane BA 180 ECTS A, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
 - *Marketing dhe Menaxhim i Shitjes, BSc 180 ECTS A, me kuotën maksimumi 75 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 3

ARSYETIM

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan brenda afatit ligjor ka parashtuar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>E-Qeverisja MA 120 ECTS R,</i>	Valbona Zeqiraj Naim Mustafa
2.	<i>Financa dhe Kontabilitet i Aplikuar BSc180 ECTS R,</i>	Arben Sahiti Arben Mustafa Nexhat Shkodra
3.	<i>Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane BA 180 ECTS A,</i>	Urtak Hamiti Selim Daku Sylë Ukshini Ardian Emiri
4.	<i>Marketing dhe Menaxhim i Shitjes, BSc 180 ECTS A,</i>	Art Shala Lulëzim Rashiti Bajram Fejzullahu

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, me ekipin e ekspertëve: Peeter Normak dhe Katerina Klimoska, Mirjana Hladika, Hans-Joachim Giessmann, Anna Bara, Marko Komso, Kristina Petljak dhe Christoph Back.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *E-Qeverisja MA 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Peeter Normak dhe Katerina Klimoska është organizuar më 24.04.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) ndërsa Substancialisht pesë (6) fusha të standardeve
- Për programin e studimit; *Financa dhe Kontabilitet i Aplikuar BSc 180 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Mirjana Hladika dhe Christoph Backi është organizuar më 28.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane BA 180 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Hans-Joachim Giessmann, Anna Bara dhe Marko Komso, është organizuar më 21.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Marketing dhe Menaxhim i Shitjes, BSc 180 ECTS A***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Kristina Petljak dhe Christoph Back, është organizuar më 28.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 125-të, të mbajtur më datë 03.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.